



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 113, Datë 21.04.2026

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT LIDHUR ME KËRKESËN
E SHOQËRISË “SUNNY SIDE ENERGY” SH.P.K. PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.04.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 856/9 prot., datë 17.04.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 856 prot., datë 09.03.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 83, datë 19.03.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.03.2026 dhe 21.03.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta (data 30.03.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.
- ERE, me shkresën nr. 856/4 prot., datë 25.03.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.
- Me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 856/7 prot., datë 14.04.2026, dhe me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 856/8 prot., datë 15.04.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacion/informacion plotësues në lidhje dëshminë e penaliatetit të vetë shoqërisë, strukturën organizative, mbështetjen financiare, planin e biznesit dhe dispoznimin e zyrave

përfaqësuese të furnizimit, por nga analizimi i këtij dokumentacioni rezulton se duhet të depozitohet dhe vërtetimi i e gjendjes gjyqësore për administratorin, vendimi i organeve drejtuese për dedikimin e fondeve për ushtrimin e veprimtarisë dhe kontrata për huapërdorjen e zyrave në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.

Zgjatja e vendimmarrjes

- Në nenin 14, pika 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, përcaktohet se: *për centralet e lidhur drejtpërdrejtë me rrjetin e shpërndarjes dhe për të gjitha licencat e tjera, bordi merr vendim jo me vonë se 30 dite nga data e publikimit të parë të njoftimit në shtyp për aplikimin për licencë*. Në nenin 14, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë*.
- Me qëllim për t’i dhënë mundësinë shoqërisë për të plotësuar dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi, vlerësohet që të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Brenda 20 (njëzet) ditëve, shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI